



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 50, datë 31.05.2022

PËR

MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, PJESË PËRBËRËSE E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021, I NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.3, 5, 7, RRUGA “BASHKIMI”, PALLATI NR.1, RRUGA “DEMOKRACIA”, PALLATI NR. 2/1, RRUGA “PROGRESIT”, PALLATI NR. 6, RRUGA “MILLENIUMI” DHE PALLATI NR. 4, RRUGA “MINIERËS”, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr.164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit nr. 471/32 prot., datë 23.05.2022 si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :**

1. Miratimin e disa shitesave në Aneksin 1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.77, datë 28.06.2021, i ndryshuar, përsa i përket listës së përfituesve që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin Nr.3,5,7, Rruga “Bashkimi”, Pallati Nr.1, Rruga “Demokracia”, Pallati Nr.2/1, Rruga “Progresit”, Pallati Nr.6 Rruga “Milleniumi” dhe Pallati Nr.4, Rruga “Minierës”, në Njësinë Administrative Manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas tabelës si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
98	MISIR DOMARKU, SHKURT DOMARKU, PETRIT DOMARKU, LULE DOMARKU	4	2+1
99	HAXHIRE BEQJA	1	1+1
100	NEXHIP PICI	3	2+1
101	ZENEL HYRA	6 (2+4)	3+1
102	ARDJANA SULA	5	3+1
103	AGIM ELEZI	3	2+1
104	BISAR HOXHA	5	3+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 474 prot.
/7

Durrës, më 07.06.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.50 datë 31.05.2022 “Për miratimin e disa shtesave në aneksin 1, pjesë përbërëse e VKB nr. 77, datë 28.06.2021, i ndryshuar, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr. 3, 5, 7, rruga “Bashkimi”, pallati nr.1, rruga “Demokracia”, pallati nr. 2/1, rruga “Progresit”, pallati nr. 6, rruga “Milleniumi” dhe pallati nr. 4, rruga “Minierës”, në njësinë administrative manëz, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

